



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr _____ Prot.

Urë Vajgurore më ____/____/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës –shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:" Mirëmbajtja e sistemit të integruar informatik për shërbimet e Bashkisë “

KODI NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Mirembajtja e pajisjeve te teknologjise se informacionit.

VLERA E FONDIT LIMIT: 23 334 000 (njëzet e tre milion e treqind e tridhjetë e katërmijë)lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia DIMAL, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:
 - a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3*
 - b. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10*

Argumentimi:Njesia e Prokurimit për pikat a. dhe b.bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, seksioni III, neni 39, pika 7, gërma “ç”. Kërkesa për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe nëVKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 30, pika 1.Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe nëVKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim ku Vlera e xhiros për të paktën një nga tre vitet e fundit financiar nga data e publikimit duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. *Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

2.3 Për kapacitetin teknik:

- Dëshmi të shërbimeve të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit financiare, me vlerë jo më të vogël se 39% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar këtë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kur shërbimet e mëparshme të ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Kur shërbimet e mëparshme të ngjashme janë realizuar me subjekte private, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne

vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën përkatëse të vlefshme ISO në përputhje me objektin e prokurimit, (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituar nga DPA ose organizma ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015** për Menaxhimin e Cilësisë;
- **ISO 20000-1** për Menaxhimin e Shërbimeve TI;
- **ISO 27001** për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit

Argumentim: Nisur nga proceset e punës kritike, rëndësisë së sistemit dhe shërbimeve që ai ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punës së tij, ti bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, efikasitet të shërbimeve të ofruara.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori ekonomik zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.

Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përjasje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.

Menaxhimi i shërbimit IT siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

Operatori ekonomik duhet te kete:

- *Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti.*

Argumentim:Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën nje punonjës të certifikuar si menaxher projekti, për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të projektit sipas standardeve dhe praktikave më të mira botërore duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit.

- *Të paktën 1 (nje) punonjës në rolin e drejtuesit teknik të projektit, të certifikuar nga prodhuesi si Solution Developer (ose ekuivalente) dhe Systems Engineer(ose ekuivalente)*

Argumentim:Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën nje punonjës të certifikuar si Solution Developer dhe System Engineer për të siguruar drejtimin teknik dhe

zhvillimin e suksesshëm të projektit sipas standardeve dhe praktikave më të mira botërore duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit.

- *Të paktën 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi si zhvillues zgjidhjesh (Solution Developer nga Microsoft ose ekuivalente).*

Argumentim: Referuar kërkesave, natyrës dhe objektit të kësaj kontrate, shërbimeve të kërkuara, detyrat specifike të ofruesit të shërbimit të ndarë në faza në përputhje me implementimin e projektit, shfaqet i nevojshëm zotërimi i stafit me kompetenca në zhvillimin e zgjidhjeve softëare.

- *Operatori ekonomik duhe të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për testues aplikacionesh*

Argumentim:Në menyrë qe kërkesat funksionale dhe teknike të përmbushen sipas kushteve të kontratës, duhen kryer testime të specializuara sipas praktikave të njohura ndërkombëtarisht. Kjo mund të sigurohet nëpërmjet punonjësve të certifikuar si testues të kredituar programi.

- *Operatori ekonomik duhe të ketë të paktën 1(nje) punonjës të certifikuar në HTML, CSS, JavaScript ose ekuivalente.*

Argumentim:HTML, JavaScript dhe CSS janë komponentë të pandashëm të zhvillimit të aplikacioneve ëeb për të implementuar komponentët sipas kërkesave të kontratës. Për krijimin e ndërfaqeve ëeb interaktive janë të domosdoshme njohuritë e përmendura në këtë kriter.

- *Operatori ekonomik duhe të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si specialist per administrimin e bazës se te dhënave te certifikuar nga prodhuesi*

Argumentim:Kjo kontratë ka për detyrë të administroje bazat e të dhënave (database) mbi të cilat funksionon sistemi ekzistues dhe të gjithë komponentët e tjerë objekt i kësaj kontrate. Për këtë arsye është kërkuar që personeli të jetë i certifikuar për administrimin e bazës se te dhënave.

- *Operatori ekonomik duhe të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).*

Argumentimi:Kërkesa për një punonjës të certifikuar për "ITIL" ose ekuivalente lidhet me rezultatet që duhet të përmbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kërkesave të shprehura në DST. Një çertifikim ITIL ose ekuivalente është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të autoritetit kontraktor. Kërkesa për çertifikim ITIL ose ekuivalente, i dëshmon autoritetit që operatori ekonomik, nëpërmjet stafit të çertifikuar si më sipër, garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të

projektit në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre.

- *Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në sisteme operimi OS (operating system)*

Argumentim: Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një punonjës të certifikuar në sisteme operimi për të përmbushur me profesionalizëm shërbimin e instalimit. Këto sisteme do të konfigurohen për të patur disponueshmeri të lartë.

- *Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në zhvillim web Services.*

Argumentim: Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një punonjës të certifikuar në zhvillim Eeb Services, për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të projektit sipas standardeve dhe praktikave më të mira botërore, duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit.

- *Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar, minimalisht nivel Ekspert në Siguri Kibernetike*

Argumentimi: Përfshirja e të paktën një punonjësi të certifikuar si Ekspert të Sigurisë Kibernetike në nivelin Ekspert është e domosdoshme për të siguruar një qasje efektive ndaj sigurisë së informacionit. Këta ekspertë kanë njohuri të thella në identifikimin e rreziqeve të sigurisë kibernetike, si dhe përdorimin e teknologjive për të parandaluar sulmet potenciale.

***Shënim:** Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim.

***Shënim:** Kërkesat për certifikimet e mësipërme duhet të vërtëtohen me Certifikatat ose Transkriptet përkatëse (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar).

***Shënim:** Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 muajve të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave.

***Shënim:** Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe prandalohen rastet e pamundësive së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj).

***Shënim:** Kriteret për punonjësit në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomike do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shoqës 10 të DST. Në rastet kur Operatori Ekonomik do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT